




**QKSS**  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Përmbledhje e shkurtër mbi Dialogun Kosovë–Serbi

# Tejkalimi i ngecjes

**A mund të tejkalohej ngecja në zbatimin e Marrëveshjes drejt Normalizimit të Marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë përmes sekuencimit alternativ të veprimeve?**



26 tetor 2023

## Pasqyrë e programit: Politika e Jashtme dhe e BE-së dhe Bashkëpunimi Rajonal i Sigurisë

Programi i Politikës së Jashtme dhe Bashkëpunimit Rajonal për Siguri është iniciativë themelore në kuadër të QKSS (Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë). I themeluar në vitin 2011 dhe i modifikuar vazhdimisht për t'iu përshtatur dinamikave rajonale në zhvillim, ky program trajton një spektër temash kritike. Këto përfshijnë mosmarrëveshjet dypalëshe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, me theks të veçantë në nxitjen e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Përveç kësaj, programi trajton tema të drejtësisë tranzicionale, pajtimit, diplomacisë publike, fushatave dezinformuese, ndikimit keqdashës të huaj, bashkëpunimit të sigurisë, zgjidhjes së konflikteve, ndërtimit të paqes dhe migrimit. Duke shërbyer si shtyllë qendrore e QKSS, ky program angazhohet në hulumtime të gjera për të adresuar çështjet me interes publik dhe për të zgjeruar ndikimin e organizatës në sferën e saj të kërkimit. Pikë qendrore e këtij programi është Samiti vjetor për Paqe dhe Demokraci në Kosovë (KPDS). KPDS shërben si një platformë që bashkon politikëbërësit, ekspertët dhe studiuesit nga Ballkani Perëndimor, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara për t'u angazhuar në dialogë kuptimplotë rreth sfidave të urgjente me të cilat përballet rajoni. Si pjesë e këtij programi, QKSS ka zhvilluar një sërë studimesh me ndikim që kanë kontribuar dukshëm në ngritjen e vetëdijes publike në Kosovë. Këto studime trajtojnë çështje thelbësore, duke përfshirë procesin e marrëveshjes së normalizimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe analizën e perceptimeve të komuniteteve lidhur me marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndëretnik.

- **Forcimi i aftësive hulumtuese:** Programi është i përkushtuar të forcojë ekipin e tij të studiuesve me ekspertizë për të trajtuar tema që lidhen me politikën e jashtme dhe bashkëpunimin rajonal.
- **Zgjerimi i Partneriteteve:** Programi synon të diversifikojë partneritetet e tij si me institucionet vendore, ashtu edhe me të BE-së dhe me institucione të tjera ndërkombëtare, me fokus të veçantë në grupet e mendimit përkatës të orientuara nga politika. Duke u angazhuar në bashkëpunime me universitetet, duke përfshirë ato që marrin pjesë në projektet Horizon të BE-së, programi mund të zgjerojë shtrirjen dhe ndikimin e tij.
- **Mbajtja e ekselencës hulumtuese:** Ruajtja e një standardi të qëndrueshëm të përsosmërisë kërkimore është me rëndësi kyçe. Programi mbetet i përkushtuar për krijimin e produkteve kërkimore me cilësi të lartë dhe kontributin aktiv në konferenca, duke siguruar kështu që puna e tij të vazhdojë të ketë një ndikim të rëndësishëm në fushën e politikës së jashtme dhe bashkëpunimit rajonal të sigurisë.



**QKSS**  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

**Përmbledhje e shkurtër mbi Dialogun Kosovë-Serbi**

# **Tejkalimi i ngecjes**

**A mund të tejkalohet ngecja në zbatimin e Marrëveshjes drejt Normalizimit të Marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë përmes sekuencimit alternativ të veprimeve?**

26 tetor 2023

# Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	1
Rishqyrtimi i sekuencimit të veprimeve të zbatimit të marrëveshjes bazë (APN)	1
Konkluzionet	4

# Hyrje

Mosmarrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mbetet një sfidë e madhe për sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e gjithë rajonit të Ballkanit Perëndimor. Në veçanti, sulmi terrorist i Banjskës i kryer nga militantët serbë kundër Policisë së Kosovës më 24 shtator 2023 (me mbështetjen e aparatit shtetëror të Serbisë, sipas hetimeve të autoriteteve kosovare) nxjerr në pah nevojën urgjente për një zgjidhje të qëndrueshme të mosmarrëveshjes së vazhdueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Rruga më premtuese drejt një zgjidhje të tillë qëndron në zbatimin e plotë të Marrëveshjes për Rrugën e Normalizimit të Marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (APN), e cila u dakordua verbalisht në Bruksel në shkurt të vitit 2023, për shkak se presidenti serb Vuçiq refuzoi ta nënshkruajë atë.

Bazuar në informatat në dispozicion, është evidente se bashkësia ndërkombëtare, duke përfshirë Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, presin që Kosova të ndërmarrë masat e nevojshme që çojnë në themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë Serbe në Kosovë (AKS), në përputhje me kornizën e saj kushtetuese dhe ligjore. Në të njëjtën kohë, Serbia pritet të ndërmarrë veprime konkrete drejt njohjes joformale të pavarësisë së Kosovës, shpesh të quajtur njohje de facto ose njohje funksionale. Të dy objektivat janë elementë themelor të Marrëveshjes për Rrugën e Normalizimit të Marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (APN).

Ky pasqyrim politikash synon të paraqesë një sekuençë alternative veprimesh, me aspiratën për të përbushur pritshmëritë e të gjitha palëve të përfshira në procesin e pajtimit.

## Rishqyrtimi i sekuençimit të veprimeve të zbatimit të marrëveshjes bazë (APN)

Nga këndvështrimi i Kosovës, zbatimi i plotë i Marrëveshjes drejt Rrugës së Normalizimit të Marrëdhënieve (APN) ofron mundësinë më praktike në kontekstin aktual për të përmirësuar marrëdhëniet me NATO-n dhe BE-në. Prandaj, Kosova duhet ta shfrytëzojë këtë momentum. Zbatimi i suksesshëm dhe i balancuar i tij ka të ngjarë të zhbllokojë procesin e integritit euroatlantik, me kusht që të ekzistojnë garanci të forta nga shtetet anëtare për të sponsorizuar rrugën e Kosovës drejt NATO-s dhe BE-së.

Duke marrë parasysh një plan të shpërndarë gjerësisht që përshkruan sekuençën e veprimeve të nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (APN), të rënë dakord nga kryeministri Kurti dhe presidenti Vuçiq në shkurt 2023 në Bruksel, ne propozojmë një rikonfigurim alternativ dhe realist të sekuençimit, në dobi të zbatimit të balancuar dhe mjaft të natyrshëm të APN-së.

Rekomandojmë që veprimi i Qeverisë së Kosovës për paraqitjen e draft-statutit për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë Serbe (ASM) duhet të pasohet njëkohësisht me hapa të menjëhershëm dhe të prekshëm të Serbisë (dhe komunitetit euroatlantik) për të zyrtarizuar procesin e njohjes "de facto (p.sh. njohjen e të gjitha dokumenteve dhe heqjen e fusnotës) si dhe ofrimi i perspektivës së qartë për anëtarësim të shtetit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, përkatësisht dhënien e statusit kandidat në BE si dhe ofrimin e Planit të Veprimit për Anëtarësim (PVA) për integrimin në NATO.

**"Nga këndvështrimi i Kosovës, zbatimi i plotë i Marrëveshjes drejt Rrugës së Normalizimit të Marrëdhënieve (APN) ofron mundësinë më praktike në kontekstin aktual për të përmirësuar marrëdhëniet me NATO-n dhe BE-në"**

Ky sekuencim duhet të adresojë , të dyja, thirrjen e bashkësisë ndërkombëtare për veprime konkrete nga qeveria drejt themelimit të ASM-së, si dhe dhënien e garancive për rrugën e integritit të Kosovës drejt sistemit ndërkombëtar – një shqetësim i arsyeshem duke marrë parasysh historinë e Kosovës me premtimet verbale që janë bërë nga BE-ja dhe akterët e tjerë ndërkombëtarë në të kaluarën, vetëm për të dëshmuar se këto premtime nuk janë realizuar. Për të adresuar këtë shqetësim, ne propozojmë një shkëmbim letrash ndërmjet udhëheqjes së Kosovës dhe Sekretarit të Shtetit Blinken, përfshirë edhe homologët e tyre francezë dhe gjermanë.

Ky shkëmbim letrash duhet të përqendroj vëmendjen në nevojën urgjente të Kosovës për të marrë statusin e kandidatit për anëtarësim në BE, të paraqesë një perspektivë të mirëfilltë për anëtarësimin në NATO (PVA) dhe të hapë rrugën për integrimin e Kosovës në sistemin ndërkombëtar (p.sh. nisja e procesit për anëtarësim në INTERPOL dhe UNESCO). Mbështetja e integritit të Kosovës në bashkësinë demokratike ndërkombëtare është një detyrim që BE-ja ka marrë në kuadër të Marrëveshjes së Asociimit dhe Stabilizim (MSA) me Kosovën (shih nenin 11 të MSA-së). Presidenti i Këshillit Evropian duhet të organizojë një samit ndërmjet Kosovës dhe pesë vendeve anëtare të BE-së që ende nuk e kanë njohur Kosovën, me qëllim të katalizimit të ndryshimeve pozitive në status quo-në aktuale. Themelimi i AKS-së dhe zbatimi i APN-së nga Kosova duhet të çojë në njohjen e Kosovës nga Qiproja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja, dhe se BE-ja së bashku me SHBA-në duhet të ndihmojnë në realizimin e kësaj.

Pas miratimit të koncept dokumentit, duhet të ketë përfitime të prekshme për Kosovën, me fokus primar sigurimin e njohjes nga pesë shtetet e mbetura anëtare të BE-së dhe Planin e Veprimit për Anëtarësim në NATO, i cili duhet të përmbyllet brenda një viti.

**TABELA 1 NJË PERSPEKTIVË ALTERNATIVE NDAJ SEKUENCIMIT TË VEPRIMEVE PËR ZBATIMIN E APN-SË.**

<b>NENI</b>	<b>KOSOVA</b>	<b>SERBIA</b>	<b>BE DHE SHBA</b>
<b>Neni 10</b>	Qeveria e Kosovës cakton anëtarët në Komitetin e Përbashkët, të kryesuar nga BE-ja, për monitorimin e zbatimit të Marrëveshjes.	Qeveria serbe cakton anëtarët në Komitetin e Përbashkët, të kryesuar nga BE-ja, për monitorimin e zbatimit të Marrëveshjes	BE mban takimin e parë të Komitetit të Përbashkët
<b>Neni 1</b>	Qeveria e Kosovës nxjerr vendimin për njohjen e dokumenteve dhe simboleve shtetërore serbe, përfshirë pasaportat, diplomat, targat dhe vulat doganore.	Qeveria e Serbisë nxjerr vendimin për njohjen e dokumenteve dhe simboleve shtetërore të Kosovës, përfshirë pasaportat, diplomat, targat dhe vulat doganore.	BE-ja informon, OKB-në, institucionet e BE-së dhe organizatat e tjera evropiane dhe rajonale se Serbia nuk kundërshton më anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare dhe se fusnota apo ylli nuk duhet të përdoren më në lidhje me Kosovën.
<b>Neni 2, 3, 4, 5, dhe 7</b>	Qeveria e Kosovës zyrtarizon statusin e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë	Serbia njofton OKB-në dhe BE-në, përmes një letre zyrtare, se nuk e përfaqëson Kosovën në sferën ndërkombëtare dhe nuk vepron në emër të saj.	Plani i Veprimit për Anëtarësim në NATO (PVA) i ofrohet Kosovës. Kosova aplikon për anëtarësim në UNESCO, INTERPOL.

<b>Neni 7</b>	Qeveria e Kosovës miraton koncept dokumentin për themelimin e Asociacionit së Komunave me shumicë Serbe në Kosovë	Serbia informon BE-në dhe OKB-në se nuk do të kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare.	The European Union (EU) grants Kosovo candidate status.
<b>Neni 7</b>	Qeveria e Kosovës miraton vendimin për themelimin e Asociacionit së Komunave me shumicë Serbe në Kosovë		Presidenti i Këshillit të BE-së organizon një samit mes Kosovës dhe pesë vendeve që nuk e njohin. Konkluzionet e përbashkëta pas samitit, çojnë në pranimin e njohjes së Kosovës.
<b>Neni 8</b>	Kosova vendos Misionin e përhershëm në Beograd, Serbi	Serbia, vendos Misionin e përhershëm në Prishtinë, Kosovë	BE-ja mbikëqyr dhe mbështet procesin, duke përfshirë hartimin e aranzhimeve praktike
<b>Neni 9</b>	Qeveria e Kosovës miraton listën e projekteve të përbashkëta të mundshme me Serbinë, si dhe anëtarët e Kosovës në një grup të përbashkët pune BE-Kosovë-Serbi për të harmonizuar projektet	Qeveria e Serbisë miraton listën e projekteve të përbashkëta të mundshme me Kosovën dhe aprovoi anëtarët e Serbisë në grupin e përbashkët punues BE-Kosovë-Serbi	BE organizon konferencën e donatorëve për projekte të përbashkëta ndërmjet Kosovës dhe Serbisë
<b>Neni 10</b>	Qeveria e Kosovës miraton planin e veprimit për zbatimin e obligimeve të mbetura nga marrëveshjet e kaluara me Serbinë	Qeveria e Serbisë miraton planin e veprimit për zbatimin e obligimeve të mbetura nga marrëveshjet e kaluara me Kosovën	BE-ja përshkruan obligimet e mbetura për zbatimin e marrëveshjeve të kaluara për Kosovën dhe Serbinë. Në bazë të këtij dokumenti Kosova dhe Serbia ndaras miratojnë planin e veprimit në qeveri për zbatimin e obligimeve
<b>Neni 6</b>	BE-ja nis me negociatat për përfundimin e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse e ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë		

Fillimi i negociatave për një marrëveshje gjithëpërfshirëse e ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë bie në sy si një aspekt kryesor i APN-së. Ky veprim nënkupton që APN-ja është duke sjellë një status quo të re, të ngjashme me një njohje de facto apo [njohje funksionale](#), e cila përfundimisht duhet të hapë rrugën për njohjen formale ose de jure të

pavarësisë së Kosovës. Në thelb, termi 'ligjërishit i detyrueshëm' kuptohet zakonisht brenda BE-së dhe rajonit si një mënyrë diskrete për t'iu referuar njohjes formale të pavarësisë së Kosovës.

## Konkluzionet

Si përfundim, zbatimi i Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, është me rëndësi të madhe për sigurinë dhe paqen në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor. Sulmi i fundit terrorist në Banjska vë në pah urgjencën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe status quo-së në veri të Kosovës. Sfida kryesore qëndron në sekuencimin e veprimeve për zbatimin e Marrëveshjes për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila ka ngecur, ndër të tjera, për shkak të mungesës së besimit dhe propozimeve që përmbajnë sekuencime të pabalancuara të veprimeve. Nga këndvështrimi i Kosovës, AKM-ja duket të jetë fija e fundit e mbetur përmes të cilit vendi mund të facilitojë ndryshimin nga status quo-ja aktuale në kuptim të anëtarësimit në BE dhe NATO, me kusht që të ketë garanci të forta nga lehtësuesit për të arritur këto aspirata.

Për të adresuar çështjen e sekuencimit, një qasje alternative e propozuar sugjeron që Kosova duhet të fillojë me themelimin e AKS-së, të ndjekur nga hapa të menjëhershëm dhe të prekshëm nga Serbia dhe Komuniteti Euroatlantik, përfshirë njohjen de facto dhe oferta për statusin e kandidatit në BE dhe Planin e Veprimit për Anëtarësim në NATO. Krijimi i AKS-së është një hap qenësor, por duhet të jetë në përputhshmëri me standardet kushtetuese dhe të lehtësojë progresin drejt anëtarësimit në BE dhe NATO, si dhe në organizata të tjera ndërkombëtare si INTERPOL dhe UNESCO, por jo edhe vetëm.

**“Për të adresuar çështjen e sekuencimit, një qasje alternative e propozuar sugjeron që Kosova duhet të fillojë me themelimin e AKS-së, të ndjekur nga hapa të menjëhershëm dhe të prekshëm nga Serbia dhe Komuniteti Euroatlantik”**





**QKSS**  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

## Rreth QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë është një qendër e pavarur kërkimore e politikave e themeluar në prill 2008 dhe me seli në Prishtinë - Kosovë. QKSS i është përkushtuar zhvillimit dhe reformave të sektorit të sigurisë në Kosovë, Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë. Ai promovon në mënyrë proaktive parimin e qeverisjes së mirë, integritetit, qëndrueshmërisë sociale, ndërtimit të paqes dhe bashkëpunimit rajonal.

QKSS e kryen rolin e saj përmes aktiviteteve intensive hulumtuese, organizimit të ngjarjeve, trajnimeve, avokimit dhe këshillave të drejtpërdrejta për politikën. Çdo vit, QKSS publikon raporte të shumta, analiza të politikave dhe përmbledhje të politikave. Ai gjithashtu organizon më shumë se 200 ngjarje publike duke përfshirë konferenca, tryeza të rrumbullakëta dhe debate, leksione që synojnë një gamë të gjerë të audiencës vendase, rajonale dhe ndërkombëtare të interesuar në sektorin e sigurisë.

Këtë vit QKSS feston 15 vjetorin e saj. Për më shumë detaje rreth QKSS, mund të kontrolloni në platformat zyrtare të mëposhtme:



[qkss.org](http://qkss.org)

[securitybarometer.qkss.org](http://securitybarometer.qkss.org)



@KCSSQKSS

#KCSSQKSS